



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Gllogoc
Zyra e Personelit
01Nr- 111/01-21523 dt. 23/09/2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Gllogoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK
Për pozitën : Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Gllogoc
Nr.referencës:	RN00004740
Pozita e punës:	Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari
Institucioni:	Drejtoria e Infrastrukturës Publike
Divizioni/njësia:	Spektori I Ndërtimit
Lloji i pozitës:	I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtori
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 8 , Koeficienti 7
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	I Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	I përherëshëm
Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave:	Niveli Profesional, grada 8, Koeficienti 7, Drejtoria e Infrastrukturës Publike.

Detyrat Kryesore:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike hartimin e paramasave , mbikëqyrjen profesionale ,pranimin e projekteve ;
2. Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Bën hartimin e paramasave dhe parallogarive për projekte për nevoja të institucionit;
4. Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
5. Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative ;
6. Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
7. Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor,(aftësitë, përvoja si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës): Diplomë universitare: Fakulteti i Ndertimtarisë dhe Arkitekturës- Drejtimi Hidroteknik, 3 vite përvojë pune profesionale, Njohuri dhe përvojë substanciale në lëminë e ndërtimit, Aftësi komunikuese, negociuese, Shkathtësi në caktim të objektivave , planifikim të punës dhe analizë, Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, AutoCad);

Vendi ku mund të merrën dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12,gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje të noterizuara dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen, të mangëtat refuzohen.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, çertifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kriterëve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data **23/04/2019** deri më **07/05 /2019**, për pozitën e cekur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqes së komunës dhe shpalljes në hyrje të komunës.



U.D. Udheheqëse e Personelit

Hanumshahe Shabani